



# Përfshirja e të drejtave të njeriut në zhvillimin e kurrikulave



**UNIVERSITET**

## IMPLEMENTING CONSORTIUM



# Përfshirja e të drejtave të njeriut në zhvillimin e kurrikulave

Përmbajtja :

1. Hyrje.....	5
2. Qëllimi.....	6
3. Metodologjia.....	7
4. Rezultatet e hulumtimit.....	8
4.1 Niveliinstitucional.....	8
Dokumentet relevante	
Vendimet relevante	
4.2 Hulumtimi në nivel të Njësive Akadematike.....	9
Përfshirja e komponentëve të të drejtave të njeriut në Kurrikula	
5. Konkluzat.....	20
6. Rekomandimet/mënyrat e mundshme për progres.....	21
7. Referencat.....	23

*Publikimi i këtijë studimi është financuar nga Agjencioni Austriak për Zhvillim dhe implementohet nga WUS Austria ( Udhëheqësi Konzorciumit). Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura këtu, nuk pasqyrojnë në asnjë mënyrë opinionin zyrtar të Agjencisë Austriake për Zhvillim, e as mendimin e partnerit implementues.*

**Autor: Besnik Loxha**  
**Zyra për Zhvillim Akademik**  
**Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”**  
**Shkurt 2018**

## 1. Hyrje

Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) në vitin 1948, shpall “deklaratën e përgjithshme për të drejtat e njeriut”, si një standard i përbashkët arritjesh për të gjithë popujt dhe të gjitha kombet, në mënyrë që çdo njeri dhe çdo organizëm shoqëror, duke pasur parasysh gjithmonë këtë Deklaratë, të përpiqen që, me anë të mësimit dhe edukimit, të ndihmonte në respektimin e këtyre të drejtave dhe lirive, ku me anë të masave progresive kombëtare dhe ndërkombëtare, të sigurohej njohja dhe zbatimi i tyre i përgjithshëm dhe i vërtetë, si midis popujve të vetë shteteve anëtare, ashtu edhe midis popujve të atyre territoreve që janë nën administrimin e tyre.<sup>(1)</sup>

Si mekanizëm për arritje nivelit më të lartë të drejtave të njeriut, në deklaratë potencohet, “mësimi” dhe “edukimi”. Më vonë, në konferencën Botërore për të Drejtat e Njeriut në Vjenë, në vitin 1993, u bëhet thirrje të gjitha shteteve dhe institucioneve, të përfshijnë të Drejtat e Njeriut, të Drejtën Humanitare, Demokracinë dhe Sundimin e Ligjit si lëndë në kurrikula në të gjitha institucionet mësimore, si në mjediset formale dhe ato jo formale<sup>(2)</sup>. Në bazë të sugjerimeve të konferencës së Vjenës, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, në rezolutën 49/184 me 23 Dhjetor 1994, shpall periudhën 10 vjeçare, duke filluar nga 1 Janari 1995, Dekada e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut në Arsim.

Bazuar në kërkesat dhe standardet e vendosura nga OKB-ja mbi të drejtat e njeriut, Kosova si shteti më i ri në botë i cili së fundmi u bashkua me familjen e kombeve të pavarura, obligohet të zbaton dhe të respekton kërkesat e OKB-së, që përmes arsimit formal dhe jo formal të ngris vetëdijen e shoqërisë mbi të Drejtat e Njeriut.

Marr parasysh se Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, si universiteti më i madh dhe më i vjetër në vend, ku momentalisht numëron rreth 50000 studentë dhe rreth 2000 persona të angazhuar si staf i universitetit, hulumtimi i përfshirjes së të drejtave të njeriut në kurrikulat e UPHP-së mund të konsiderohet si rezultat dhe tregues signifikant edhe në nivel të Kosovës, apo të arsimit të lartë në Kosovë.

Përmes këtij punimi do të hulumtohet përfshirja e disa elementeve dhe komponentëve të të drejtave të njeriut në kurrikula të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”. Do të paraqiten fakte kuantitative dhe hulumtim përmes “desk research” me përpunimin e të dhënave statistikore mbi përfshirjen e elementeve të ndryshme të të drejtave të njeriut në Arsimin e Lartë të Kosovës përmes përfshirjes së dokumenteve relevante dhe programeve të studimit, me synim që të epet përgjigje në dy pyetje:

- 1) Deri në çfarë mase trajtohen të drejtat e njeriut në planprogramin ekzistues në Universitet dhe
- 2) Si trajtohen ato nga Universiteti.

<sup>(1)</sup> Deklarata e Përgjithshme Mbi Te Drejtat E Njeriut, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara 10 Dhjetor 1948.

<sup>(2)</sup> Për më tepër, shiko dokumentin e Kombeve të Bashkuara: 12 December 1996 - HUMAN RIGHTS QUESTIONS: HUMAN RIGHTS QUESTIONS, INCLUDING ALTERNATIVE APPROACHES FOR IMPROVING THE EFFECTIVE ENJOYMENT OF HUMAN RIGHTS AND FUNDAMENTAL FREEDOMS

Kur bëhet fjalë për “Masën e trajtimit”, fokusi do të jetë në aspektin kuantitativ, ku do të hulumtohet frekuenca e indikatorëve të përzgjedhur në hulumtim, në pjesë të ndryshëm të subjektit hulumtues (dokumente dhe kurrikulave).

Kur bëhet fjalë për “Si”, fokusi do të jetë në cilësinë e të dhënave që do të gjenerohen nga hulumtimi, pra do të analizohet natyra e trajtimit të indikatorëve në pjesë të ndryshme të subjektit hulumtues (dokumente dhe kurrikulave).

Edhe pse, të drejtat e njeriut përfshijnë në vetvete shumë komponentë të ndryshme, në gjatë këtij hulumtimi i kemi përfshirë dhe përdor disa indikatorë përmes të cilave kemi tentuar ta krijojmë një pasqyrë më të gjerë të përfshirjes dhe trajtimit të drejtave të njeriut në Universitet dhe arsimin e lartë, dhe këtë dukeu fokusuar në hulumtimin e përfshirjes së të drejtave të njeriut në mësim dhe edukim përmes programeve të studimit, ku si indikator të shqyrtimit kemi:

- E drejta e njeriut
- Nevoja të veçanta
- Etikë, dhe
- Barazi gjinore

Përmes këtyre indikatorëve janë paraqitur të dhëna faktike, se në çfarë mase dhe si është e përfshirë e drejta e njeriut në kurrikula dhe përmes saj në sistemin e arsimit të lartë.

Në studim kemi përfshirë një numër të konsiderueshëm të programeve të studimit, përmes të cilave janë marr të dhëna relevante, ku në vazhdim të këtij punimi do të prezantohen.

## 2. Qëllimi

Qëllimi i këtij hulumtimi, së pari është të paraqitet gjendja aktuale e përfshirjes së të drejtave të njeriut në kurrikulë, si aspekt teorik dhe fundamental për avokimin dhe sensibilizim të shoqërisë mbi këtë çështje dhe së dyti, të paraqitet gjendja faktike dhe reale, se sa institucioni trajton çështjen e të drejtave të njeriut.

Gjithashtu, përveç qëllimeve të lartcekura paraqitja faktike e trajtimit të të drejtave të njeriut në kurrikula do tu mundësoj hulumtuesve të ri që në bazë të dhënave që do të ofrohen në këtë studim, të zhvillojnë dhe zgjerojnë hulumtimet edhe në fusha dhe komponentë të tjera të të drejtave e që nuk janë përfshirë në këtë studim.

Dhe qëllimi i fundit dhe jo më pak i rëndësishëm është, të dhënat dhe të gjeturat faktike të shërbejnë si pikë-nisje e krijimit të strategjive dhe politikave për ngritjen e vetëdijesimit për gjendjen faktike të të drejtave njeriut në arsimin e lartë.

## 3. Metodologjia

Gjatë procesit të hulumtimit të përfshirjes të të drejtave të njeriut në kurrikula, është përdor metoda “desk research” e hulumtimit. Për ta përshkruar gjendjen faktike në lidhje me trajtimin e të drejtave të njeriut në kurrikula, gjatë hulumtimit është marr për bazë gjendja ekzistuese dhe të dhënat faktike në programet e studimit të Fakulteteve të Universitetit të Prishtinës.

Hulumtimi në shqyrtim ka përfshirë edhe dokumentet relevante si Statuti i UPHP-së dhe dokumente tjera si, rregullore dhe vendime të menaxhmentit të UPHP-së.

Në hulumtim janë përfshirë 9 Njësi Akademiketë UPHP-së. Është tentuar që procesi i të jetë sa më divers dhe hulumtimi të zhvillohet në sa më shumë programe të ndryshme dhe fusha dhe disiplina të ndryshme të studimit. Andaj nga gjithsej 144 programe të studimit që ofrohen nga UPHP-ja, në hulumtim janë përfshirë 74 apo 51% të programeve të fushave dhe niveleve të ndryshme të studimit. Në nivelin BA të studimit janë përfshirë 28 programe apo 42% e programeve që ofrohen në UPHP, në nivelin MA 38 apo 63%, dhe PhD 8 apo 47% të programeve të studimit. Ndërsa, në nivel të shtetëror, nga 288 programe të studimit që ofrohen nga sistemi i arsimit të lartë të Kosovës, hulumtimi përfshinë 26 % të programeve të studimit.

Gjithashtu, janë përfshirë edhe 29 dokumente relevante, nga këto janë shqyrtuar 13 rregullore dhe 16 vendime.

Për të marr të dhëna më të detalizuara dhe më gjithëpërfshirëse, hulumtimi në nivel të programeve të studimit është ndarë në 5 pjesë apo nivele. Kërkimet janë zhvilluar në:

- Përshkrim dhe qëllimi i programit
- Rezultatet e të nxënit të programit
- Lëndë
- Përshkrim të lëndës
- Rezultatet e të nxënit të lëndës

Në secilën pjesë të programit të studimit është kërkuar përdorim i fjalëve (fjalët kyqe), e drejta e njeriut, nevoja të veçanta, etikë, dhe barazi gjinore.

## 4. Rezultatet e hulumtimit

### 4.1. Niveli Institucional

#### Dokumentet relevante:

Në këtë pjesë kemi të shqyrtuar 13 dokumente relevante, përfshirë këtu edhe Statusin e Universitetit. Nga 12 Rregullore vetëm në 3 Rregullore trajtojnë çështjet si: Etikë, Barazi gjinore dhe Nevoja të veçanta, dhe atë siç është paraqitur në Figurën 1.




Figura 1: Dokumentet relevante

Në statutin e Universitetit kemi një rast ku Barazia Gjinore potencohet, ndërsa komponentët e tjera si; e drejta e njeriut, nevoja të veçanta, etikë, nuk potencohen në forma specifike që i shërbejnë kontekstit të të drejtave të njeriut në aspektin avokues dhe objektivave të këtij hulumtimi .

Ndërsa, “e drejta” në kontekst të mbrojtjes së të drejtave të studentëve dhe personelit të UP-së, si të drejta dhe obligime, ka raste të potencimit më të shpeshtë, mirëpo, kjo çështje nuk është subjekt i këtij hulumtimi <sup>(3)</sup>.

Në “Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunorëve”, Barazia gjinore, siç shihet në Figurën 1, është potencuar në 4 raste në 3 pjesë të ndryshme të rregullores, mirëpo potencimi paraqitet për kontekst të njëjtë <sup>(4)</sup>. Ndërsa elementet tjera të të drejtave të njeriut, të cilat janë subjekt i hulumtimit tonë, nuk potencohen.

<sup>(3)</sup> Neni 8 i statutit të Universitetit të Prishtinës garanton Barazi Gjinore në rastet e aplikimit për punë. Në këtë nen potencohet se, “Universiteti siguron dhe mbështetë barazinë gjinore. Në rastet kur kandidatët e gjinisë mashkullore dhe femërore i kanë kualifikimet dhe te arriturat profesionale të barabarta, përparësi do t’i jepet kandidatës femër.”

Në “Rregulloren për masat dhe procedurat disiplinore ndaj personelit akademik”, Etika, paraqitet në 10 raste në 7 pjesë të ndryshme të rregullores.<sup>(6)</sup>

Ndërsa në “Kodin e etikës”, Barazia gjinore paraqitet në 6 raste, dhe Nevoja të veçanta në 3 raste të ndryshme <sup>(6)</sup>.

#### Vendimet relevante:

Për çështje të këtij studimi janë hulumtuar 16 vendime të ndryshme (dokumente publike) të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, që datojnë nga viti 2014 deri në vitin 2017. Si rezultat, nga 16 vendime, vetëm në 1 dokument (vendim) është paraqit aspekti i Nevojave të veçanta dhe atë në kontekst të lirimit nga pagesa studentët me nevoja të veçanta.

### 4.2 Hulumtimi në nivel të Njesisë Akademike

Përfshirja e komponentëve të të drejtave të njeriut në Kurrikula:

Në hulumtim janë përfshirë 51% e programeve të studimit që ofrohen nga njësitë akademike të UPHP-së ku janë kërkuar elementet apo Indikatorë, të potencuar më lartë, si:

- E drejta e njeriut
- Nevoja të veçanta
- Etikë, dhe
- Barazi gjinore

Këto indikatorë, janë kërkuar në 5 pjesëtë ndryshme të kurrikulave si:

- Përshkrim dhe qëllim të programit
- Rezultatet e të nxënit të programit
- Lëndë
- Përshkrim të lëndës
- Rezultatet e të nxënit të lëndës

<sup>(4)</sup> Për më shumë shiko “Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunorëve”- Neni 7.

<sup>(5)</sup> Për më shumë shiko “Rregulloren për masat dhe procedurat disiplinore ndaj personelit akademik” – parimet e përgjithshme, Neni 2, Neni 3, Neni 6, Neni 7 dhe 11.

<sup>(6)</sup> Për më shumë shiko “Kodin e etikës” – Neni 8 paragrafi 4, Nen 12 paragrafi 2 dhe Neni 14 paragrafi 5.

Në shkencat e bujqësisë dhe veterinarisë, në dy nivele të studimit (BA dhe MA), kemi 3 programe dhe 69 lëndë të përfshira në hulumtim dhe atë, në Bachelor 1 program i studimit dhe 27 lëndë të po të njëjtit program, ndërsa në nivelin Master të studimit kemi 2 programe dhe 42 lëndë.

Të gjeturat në programin e nivelit Bachelor rezultojnë me, përfshirjen e parametrin Etika, në 2 lëndë të programit, ndërsa parametrat tjerë të hulumtimit si, E drejta e njeriut, Nevoja të veçanta dhe Barazia gjinore nuk trajtohen nga programi në fjalë.

Ndërsa në dy programet e nivelit Master të studimit nuk i trajtojnë fare komponentët e potencuar.

- Përshkrim të programit
- Lëndë
- Rezultate të nxënimit të lëndës
- Rezultate të nxënimit të programit
- Përshkrim të lëndës




Figura 2: Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, niveli Bachelor i studimit.

Në shkencat e mjekësisë, përkatësisht, në Fakultetin e Mjekësisë, janë përfshirë 10 programe të studimit dhe gjithsej 505 lëndë që i përkasin po këtyre programeve. Në nivelin Bachelor, kemi 2 programe dhe 101 lëndë, në Master 4 programe dhe 319 lëndë, dhe në nivelin PhD kemi 4 programe të studimit dhe 85 lëndë të përfshira në hulumtim.

Siç shihet në Figurën 3, në 2 programet e studimit të nivelit Bachelor, kemi indikatorin Etika që paraqitet në 9 raste të ndryshme. Në Përshkrim të programit është paraqitur në 2 raste, në Rezultate të nxënimit të programit në 1 rast, në Lëndë si përmbajtje kryesore në 2 raste, në Përshkrim të lëndës në 2 raste dhe rezultate të nxënimit të lëndës në 2 raste.

Ndërsa parametri Nevoja të veçanta, është paraqitur në 2 raste, dhe atë në Rezultatet e të nxënimit të lëndës. Indikatorët si, Të drejtat e njeriut dhe Barazia gjinore, nuk paraqiten në këto programe të studimit të nivelit Bachelor.




Figura 3: Fakulteti i Mjekësisë, niveli Bachelor i studimit.

Në programet e studimit të nivelit Master, në Fakultetin e Mjekësisë, ashtu siç është paraqitur në figurën 4, indikatorin Të drejtat e njeriut, është paraqitur në 3 raste në Përshkrim të lëndës, dhe në 3 raste në Rezultatet e nxënimit të lëndës.

Barazia gjinore, është paraqitur në 1 rast, dhe atë në Rezultate të nxënimit të programit.

Etika është paraqitur në 1 rast në Përshkrim të programit, në 2 raste në Përshkrim të lëndës, dhe në 3 raste në Rezultate të nxënimit të lëndës.

Nevoja të veçanta, është paraqitur në 2 raste në Përshkrim të programit, në 2 raste në Lëndë dhe në 1 rast në Përshkrim të lëndës.




Figura 4: Fakulteti i Mjekësisë, niveli Master i studimit



Në 4 programet e studimit dhe 85 lëndë të përfshira në nivelin PhD të studimit, në Fakultetin e Mjekësisë, ashtu siç është paraqitur në figurën 5, indikatorit Etika, është paraqitur në përshkrim të programit në 2 raste, në Rezultate të nxënimit të programit është paraqitur në 2 raste dhe Lëndë si përmbajtje kryesore në 6 raste. Ndërsa, indikatorët si Të drejtat e njeriut, Barazia gjinore dhe Nevoja të veçanta, nuk paraqiten në programet e shqyrtuara të nivelit PhD.



Figura 5: Fakulteti i Mjekësisë, niveli PhD i studimit

Në shkencat sociale, në tri nivele të studimit (Ba, Ma dhe PhD), janë përfshirë në hulumtim 15 programe të studimit dhe 347 lëndë.

Në programet e Fakultetit Filozofik janë të përfshira 6 programe dhe 179 lëndë.

Në nivelin Bachelor janë të përfshirë 3 programe dhe 137 lëndë, ndërsa në atë Master janë të përfshirë 3 programe të studimit dhe 42 lëndë.

Siç shihet në Figurën 3, në programet Bachelor, parametri E drejta e njeriut është e përfshirë në Përshkrim të programeve të studimit në 2 raste, në Rezultate të nxënimit të programit është e përfshirë në 1 rast, në Lëndë si përmbajtje kryesore në 5 raste, dhe në Rezultatet të nxënimit të lëndës në 1 rast.

Parametri Barazia gjinore, është e përfshirë në Lëndë si përmbajtje kryesore në 2 raste, dhe në Rezultate të nxënimit të lëndës në 1 rast.

Indikatorit Etika, është e përfshirë në Përshkrim të programeve të studimit në 1 rast, në Rezultate të nxënimit të programit kemi të përfshirë në 1 rast, në Lëndë si përmbajtje kryesore në 4 raste, në Përshkrim të lëndës në 1 rast, dhe Rezultate të nxënimit të lëndës 4 raste.

Indikatorit Nevoja të veçanta, është përfshirë në Lëndë si përmbajtje kryesore në 2 raste, dhe në Përshkrim të programit në 1 rast.




Figura 6: Fakulteti Filozofik, niveli Bachelor i studimit.

Në programet e hulumtuara të nivelit Master, ashtu siç është paraqitur në figurën 4, shihet se Të drejtat e njeriut, në Lëndë<sup>(7)</sup> si përmbajtje kryesore është paraqitur në 1 rast, ndërsa në Përshkrim të lëndës është paraqitur në 3 raste.

Indikatorit Barazia gjinore, në Rezultate të nxënimit të programit është paraqitur në 2 raste, në Përshkrim të lëndës paraqitet në 1 rast, dhe në rezultatet të nxënimit të lëndës paraqitet në 1 rast.

Etikasi indikatorë, në Përshkrim të programit paraqitet në 1 rast, në Lëndë si përmbajtje kryesore është paraqitur në 1 rast, në Përshkrim të lëndës paraqitet në 1 rast, dhe në Rezultate të lëndës paraqitet në 2 raste. Ndërsa indikatorit Nevoja të veçanta në asnjë rast.

(7) Kur e potencojmë si Lëndë, nënkupton që emërtimi i lëndës ka të përfshirë, parametrin, si pjesë përbërëse të emërtimit.

- Përshkrim të programit
- Lëndë
- Rezultate të nxënit të lëndës
- Rezultate të nxënit të programit
- Përshkrim të lëndës




Figura 7: Fakulteti Filozofik, niveli Master i studimit.

Në Fakultetin Juridik janë të përfshira 9 programe të studimit dhe 168 lëndë.

Siç është e paraqitur në Figurat 5, 6 dhe 7, në nivelin Bachelor është e përfshirë 1 program i studimit dhe 81 lëndë, ndërsa në Master janë të përfshirë 6 programe të studimit dhe 81 lëndë, ndërsa në PhD, janë të përfshira 2 programe të studimit dhe 6 lëndë.

Të drejtat e njeriut, në Lëndë si përmbajtje kryesore është paraqitur në 1 rast, dhe në Përshkrim të lëndës gjithashtu është paraqitur në 1 rast.

Etika si parametër është paraqitur vetëm në 1 rast dhe atë në Lëndë si përmbajtje kryesore.

Ndërsa, Barazia gjinore dhe Nevoja të veçanta nuk potencohen në programet e nivelit Bachelor.

- Përshkrim të programit
- Lëndë
- Rezultate të nxënit të lëndës
- Rezultate të nxënit të programit
- Përshkrim të lëndës




Figura 8: Fakulteti Juridik, niveli Bachelor i studimit.

Të drejtat e njeriut si indikatorë relevant, në nivelin Master është paraqitur në 2 raste në Rezultatet e nxënit të programit, në 4 raste paraqitet si Lëndë si përmbajtje kryesore, ndërsa në Përshkrim të lëndës paraqitet në 3 raste.

Etika si indikatorë paraqitet në 2 raste në pjesën e Përshkrimit të lëndës.

Ndërsa Barazia gjinore dhe Nevoja të veçanta nuk potencohen në programet e shqyrtuara të nivelit Master të studimeve të Fakultetit Juridik.

- Përshkrim të programit
- Lëndë
- Rezultate të nxënit të lëndës
- Rezultate të nxënit të programit
- Përshkrim të lëndës




Figura 9: Fakulteti Juridik, niveli Master i studimit.

Në nivelin e PhD të studimit, ku janë të përfshirë 2 programe dhe 6 lëndë, parametri Të drejtat e njeriut është paraqitur në 2 raste në Rezultatet e nxënit të programit. Ndërsa parametrat tjerë nuk potencohen.






Figura 10: Fakulteti Juridik, niveli PhD i studimit.

Në Fakulteti i Edukimit janë përfshirë 9 programe të studimit dhe 500 lëndë të nivelit Bachelor dhe Master të studimit.

Ashtu siç mund të shihet në Figurën 9, në nivelin Bachelor janë të përfshira 3 programe të studimit dhe 155 lëndë.

Indikatori Të drejtat e njeriut, është paraqitur në dy raste dhe atë, në 1 rast në Lëndë si përmbajtje kryesore dhe në 1 rast në Përshkrim të lëndës.

Indikatori Barazia gjinore, është paraqitur vetëm në një rast në Lëndë si përmbajtje kryesore.

Etika, është e paraqitur, gjithsej në 5 raste dhe atë, në 2 raste e kemi të paraqitur në Lëndë si pjesë kryesore, në 1 rast është e paraqitur në Përshkrim të lëndës dhe në 2 raste në Rezultate të nxënimit të lëndës.

Parametri Nevoja të veçanta, gjithsej është paraqitur në 5 raste. Në 3 raste është paraqitur në Përshkrim të lëndës dhe në 2 raste e kemi në Rezultate të nxënimit të lëndës.




Figura 11: Fakulteti i Edukimit, niveli Bachelor i studimit.

Ndërsa në nivelin Master të Fakultetit të Edukimit, ashtu siç shifet në Figurën 10, kemi të përfshira 6 programe të studimit dhe 345 lëndë.

Indikatori Të drejtat e njeriut, është e përfshirë në 7 raste në Përshkrim të lëndës.

Barazia gjinore, është e përfshirë në 1 rast në Rezultate të nxënimit të programit.

Etika si indikatorë, është e përfshirë në 4 raste të ndryshme. Në 1 rast është paraqitur në Përshkrim të programit, në 1 rast është paraqitur në Lëndë si përmbajtje kryesore, dhe në 2 raste në Përshkrim të lëndës.

Indikatori Nevoja të veçanta, është paraqitur në 6 raste të ndryshme. Në 2 raste e kemi të paraqitur në Përshkrim të programit, në 2 raste në Përshkrim të lëndës, dhe në 2 raste në Rezultate të nxënimit të lëndës.




Figura 12: Fakulteti i Edukimit, niveli Master i studimit.

Në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit, në hulumtim janë të përfshira 3 programe të studimit dhe 104 lëndë. Në Figurat 11 dhe 12 janë të paraqitur të gjeturat për nivelet Bachelor dhe Master.

Në nivelin Bachelor është përfshirë në hulumtim 1 program i studimit dhe 62 lëndë.

Nga të gjeturat e hulumtimit rezulton se Etika si indikatorë është paraqitur në 4 raste të ndryshme, dhe atë, në Rezultate të nxënës të programit është paraqitur në 1 rast, në Lëndë si përmbajtje kryesore është paraqitur në 1 rast, dhe në Përshkrim të lëndës në 2 raste. Ndërsa indikatorët, Të drejtat e njeriut, Barazia gjinore dhe Nevoja të veçanta nuk rezultojnë si indikatorë të paraqitur në program dhe lëndët e studimit të nivelit Bachelor.




Figura 13: Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit, niveli Bachelor i studimit.

Në nivelin Master, në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit, janë të përfshira në hulumtim 2 programe dhe 42 lëndë. Siç është paraqitur në Figurën 12, indikatori Etika, rezulton të jetë paraqitur në 5 raste të ndryshme. Në 1 rast është paraqitur në Lëndë si përmbajtje kryesore, në 2 raste është paraqitur në Përshkrim të lëndës dhe në 2 raste në Rezultate të nxënës të lëndës.

Indikatori Nevoja të veçanta, rezulton të jetë përfshirë vetëm në një rast dhe atë në Përshkrim të programit.

Ndërsa indikatorët Të drejtat e njeriut dhe Barazia gjinore, nuk rezultojnë të janë shfaqur në lëndët dhe programet e studimit.




Figura 14: Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit, niveli Master i studimit.

Në programet e shkencave teknike dhe të shkencave të natyrës janë përfshirë 34 programe të studimit dhe 1079 lëndë, përfshirë këtu tri nivelet e studimit, atë Bachelor, Master dhe PhD. Nga hulumtimi ka rezultuar që indikatorët e kërkuar nuk janë të përfshirë në asnjë rast, rezultati për këto programe dhe lëndë është zero (= 0).

## 5. Konkluzë

Nga hulumtimi mund të konkludohet se të gjeturat mund të ndahen në tri kategori, në:

- Të gjeturat e rëndësishme të veçanta,
- Preventive, dhe
- Zbatuese

Sipas rezultateve të hulumtimit të dokumenteve relevante, duket qartë se mungon rregullore dhe vendimet e marra nga organet përkatëse të Universitetit për promovimin e të drejtave të njeriut në Universitet.

Rëndësia e parametereve (E drejta e njeriut, Nevoja të veçanta, Etikë, Barazi gjinore) është ndarë sipas nivelit hierarkik të përfshirjes në kurrikula (Përshkrim dhe qëllim të programit, Rezultatet e të nxënimit të programit, Lëndë, Përshkrim të lëndës, Rezultatet e të nxënimit të lëndës). Ato parametra të cilat potencohen më shumë në pjesën e rezultateve të nxënimit dhe në Lëndë, ato konsiderohen se kanë nivel më të lartë të rëndësishme, sepse, studenti për parametrin në fjalë pas përfundimit të studimeve pritët që të ketë njohuri në zbatueshmërinë e konceptit, në këtë rast, studenti do të jetë në gjendje që konceptet bazë mbi parametrin e potencuar në program, të jetë në gjendje të zbatoj dhe kuptoj më mirë pas përfundimit të kursit (lëndës) apo edhe programit të studimit.

Në Figurën 15, janë paraqitur parametrat sipas rëndësishme hierarkike në kurrikula.




Figura 15: Rezultatet sipas rëndësishme hierarkike të programit.

Etika si parametër i shqyrtimit, në 74 programet e shqyrtuara, gjithsej është potencuar në 62 raste apo nivele të ndryshme të kurikulës. Etika si parametër rezulton që është më e përfshira në programet e njësive akademike, krahasuar me tre parametrat tjerë si Të drejtat e njeriut ku është e përfshirë në 41 raste në nivele të ndryshme të kurikulës, pastaj pason parametri Nevoja të veçanta i paraqitur në 20 raste, dhe në fund e kemi Barazia gjinore ku është e përfshirë në 10 raste dhe pjesë të ndryshme të kurrikulës.

Nga disa njësi akademike, në programet e studimit ofrohen mësimet dhe tema që kanë të bëjnë, më shumë, me aspektin e krijimit të kushteve preventive për çështjet e mbrojtjes të të drejtave të njeriut dhe komponentëve të saj, përmes mësimet, në kuptim të mësuarit mbi sensibilizimin dhe evokimin e çështjes të të drejtave të njeriut.

Ndërsa në disa njësi akademike, ofrohen programe të studimit që kanë të bëjnë me mësimet e zbatimit të masave konkrete apo masave mbrojtëse të parapara me ligj për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Nga hulumtimi ka rezultuar se trajtimi i të drejtave të njeriut nuk përfshihen në të gjitha programet studimeve që ofrohen nga njësitë akademike të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”. Ashtu siç tregojnë faktet, në programet e studimit të fakulteteve teknike dhe asaj të natyrës nuk trajtohen çështjet e të drejtave të njeriut, por edhe etika si komponent apo si parametër e cila është përfshirë në këtë hulumtim. Ndërsa, në programet e shkencave sociale, të mjekësisë, bujqësisë dhe veterinarisë dhe edukimit trajtohen në një masë relative, por jo në intensitet, formë dhe mënyrë të njëjtë.

Përbrenda studimeve të shkencave shoqërore, dallojnë programet e studimit në trajtimin e të drejtave të njeriut. P.sh. Fakulteti Juridik, të drejtat e njeriut trajtohen nga prespektiva ligjore. Ndërsa në programet e Fakultetit Filozofik dhe Edukimit, të drejtat e njeriut dhe komponentet e saja trajtohen më shumë nga aspekti avokues, parandalues dhe rritjes së ndërgjegjësimit.

## 6. Rekomandimet/mënyrat e mundshme për progres

Në mënyrë që të kemi një pasqyrë sa më të qartë të përfshirjes së të drejtave të njeriut në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, ishte e domosdoshme që në hulumtim të përfshihen një numër i Njësive Akademike me programe të ndryshme të studimit.

Përmes përfshirjes së programeve të ndryshme studimore në këtë hulumtim për të drejtat e njeriut në kurrikula, u bë e qartë se disa fakultete (njësitë akademike) fokusohen ekskluzivisht në përgatitjen profesionale të studentëve në fushën e veçantë të studimit pa marrë parasysh kontekstin më të gjerë shoqëror dhe relevancën që ka dimensionin e të drejtave të njeriut në shoqëri. Prandaj rekomandohet që njësitë akademike të reflektojnë në kurrikulën e tyre për aspektet relevante të të drejtave të njeriut.

Megjithatë të drejtat e njeriut nuk duhet të trajtohen në të njëjtën mënyrë në të gjitha programet e studimit, por duhet të trajtohen në kontekstin e fushës së studimit, perceptimi se në disa fusha të studimit nuk është e nevojshme mësimi për të drejtat e njeriut gjithashtu mund të konsiderohet si qasje e gabuar nga njësitë akademike. Ka fakte të mjaftueshme, që në botën e hulumtimit nëse nuk ekziston kodi i etikës apo edukimi për të drejtat e njeriut të cilat mund të parandalojnë abuzime

të ndryshme me rastin e shpikjeve/zbulime (patenteve etj) që mund të kenë ndikim negativ në njerëzimin, mund të konsiderohet se probabiliteti për ndikim negativ në të drejtën e njeriut mund të jetë i lartë. Prandaj, përfshirja dhe trajtimi i të drejtave të njeriut në kurrikula duhet të jetë pjesë shumë e rëndësishme e mësimdhënies si pjesë integrale e arsimit sidomos në programet e studimeve të nivelit Master dhe PhD.

Ashtu siç është paraqitur edhe në këtë punim hulumtues, në programet e studimit të shkencave teknike dhe shkencave natyrore nuk ka ndonjë element të të drejtave të njeriut të përfshira në kurrikula të cilat kanë qenë temë e këtij hulumtimi.

Nga rezultatet e hulumtimit tregohet se në programet e studimeve shoqërore, edukimit, mjekësisë, bujqësisë dhe veterinare, të drejtat e njeriut trajtohen deri në një masë të konsiderueshme, ka 133 raste ku parametrat përfshihen në programet e studimit. Por ky hulumtim nuk tregon se si trajtohen parametrat apo si u paraqiten studentëve.

Kur është fjala për shkencat teknike, minimum “etika” si një komponent i veçantë i paraqitur në këtë hulumtim duhet të përfshihet si pjesë e programit të studimit si një lëndë e veçantë, veçanërisht në nivelet Master dhe PhD të studimeve.

Kur bëhet fjalë për shkencat natyrore, njësoj si në shkencat teknike, komponentët e të drejtave të njeriut duhet të jenë pjesë e kurrikulës, duke marrë parasysh ndikimin që kanë këto programe studimi në shoqëri dhe në natyrë.

Ndërsa, në ato kurrikula që trajtohen të drejtat e njeriut, duhet të rishikohen parametrat e të drejtave të njeriut në mënyrë që të plotësohen kriteret për ngritjen e vetëdijes dhe avokimit.

Në nivelin e institucionit, Universiteti duhet t'i kushtojë më shumë vëmendje çështjes së të drejtave të njeriut duke mbështetur qendrat e të drejtave të njeriut në Universitet dhe gjithashtu duke organizuar më shumë trajnime dhe seminare për studentët dhe stafin e Universitetit.

Qendrat e të drejtave të njeriut duhet të angazhohen dhe të shtojnë përkushtimin për të organizuar kurse ekstra-kurrikulare në fushën e të drejtave të njeriut.

Do të jetë gjithashtu thelbësore për të zhvilluar dhe përpiluar më tej dokumentet përkatëse për informacion, edukim dhe komunikim (duke përfshirë ngritjen e vetëdijes dhe materialeve mësimore) me qëllim të promovimit të të drejtave të njeriut për studentët dhe stafin e universitetit.

## 7. Referencat

- Wolfgang Benedek, Eva Bravc, Lisa Heschl, Anna Leichtfried und Nora Scheucher; Baseline Study „Menschenrechtsbildung an den höheren Bildungsinstitutionen in Österreich“;Graz, July 2012.
- Wolfgang Benedek, Nora Scheucher; Menschenrechtsbildung an österreichischen Univeritäten; Ergebnisse der Basisstudie (für Österreich); Bildung, Menschenrechte, Universität; Jahrbuch Friedenskultur 2012.
- Deklarata e Përgjithshme Mbi Te Drejtat E Njeriut, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara 10 Dhjetor 1948
- HUMAN RIGHTS QUESTIONS: HUMAN RIGHTS QUESTIONS, INCLUDING ALTERNATIVE APPROACHES FOR IMPROVING THE EFFECTIVE ENJOYMENT OF HUMAN RIGHTS AND FUNDAMENTAL FREEDOMS
- StatutiiUniversitittëPrishtinës
- Rregullorja e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve
- Rregullorja për masat dhe procedurat disiplinore ndaj personelit akademik
- Kodi i etikës